REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës 26.06.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

1.A ka patur bashkia buxhet vjetor të planifikuarpër rininë për periudhën Janar-Dhjetor 2025. Nëse po, sa është ky buxhet dhe sa % të shumës totalit të buxhetit të bashkisë zënë këto zëra?

Për vitin 2025 buxheti për rininë ka qenë në total 20,980,650 lekë , ose 0.38% e buxhetit total dhe ka qenë për këto zëra:

1. Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave konomike lokale 4,000,000 lekë
2. Shperblim për nxënësit e shkollave të mesme me rezultatet të larta 2,000,000 lekë
3. Nxënës në nevojë të arsimit të mesëm që përfitojnë bursë 9,880,650 lekë
4. Karta e studentit: 5,000, 000 lekë

2. A ka përfituar Bashkia projekte të financuara nga donatorë që synojnë rininë gjatë vitit 2025? Ku konsistojnë këto projekte?

Në vitin 2025, Bashkia Durrës, mbas riaplikimit nga Njësia e Integrimit Evropian, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, është përfituese në projektit **Europe Goes Local**, të financuar nga programi ERASMUS +. Ky Projekt zhvillohet gjatë periudhës **2021–2027**.

Europe Goes Local është një projekt bashkëpunimi evropian që synon zhvillimin dhe forcimin e punës rinore në nivel lokal.Misioni i Europe Goes Local është të forcojë komunitetin e praktikës së punës rinore në nivel lokal, në përputhje me Agjendën Evropiane për Punën Rinore dhe nga perspektiva e bashkive dhe aktorëve lokalë të punës rinore.

Platforma **Europe Goes Local** bashkon partnerë të përfshirë në promovimin, mbështetjen, zhvillimin dhe zbatimin e punës rinore në nivel lokal, duke përfshirë si strukturat dhe institucionet qeveritare, ashtu edhe organizatat joqeveritare.

Platforma synon të krijojë dialog dhe bashkëpunim, duke ofruar aktivitete konkrete, mundësi për të nxënë dhe rrjetëzim, mjete praktike dhe burime njohurish. Shtrirja e saj gjeografike përfshin vendet pjesëmarrëse dhe vendet fqinje/partnere të programeve **Erasmus+ Rinia** dhe **Korpusi Evropian i Solidaritetit**, si dhe rrjete evropiane dhe kombëtare, organizata ombrellë, **Qendrat Burimore SALTO**, iniciativa të tjera në shkallë të gjerë dhe projekte të bashkëpunimit strategjik.

Projekti financohet përmes kontributeve të Agjencive Kombëtare pjesëmarrëse, në kuadër të programeve **Erasmus+** (Aktivitetet e Trajnimit dhe Bashkëpunimit) dhe/ose **Korpusi Evropian i Solidaritetit** (Aktivitetet e Rrjetëzimit).

Të gjithë partnerët ftohen të kontribuojnë në mënyrë aktive në aktivitetet e platformës përmes:

- shkëmbimit të njohurive dhe përvojave,
- krijimit të mjeteve dhe burimeve të reja,
- rrjetëzimit,
- avokimit,
- dhe shpërndarjes së rezultateve të projektit.

Mjetet themelore të platformës për zhvillimin cilësor të punës rinore në nivel lokal janë:

- European Charter on Local Youth Ëork (**Karta Evropiane për Punën Rinore Lokale**);
- Changemakers Kit (**Paketa Changemakers**).

Me aktivitetin evropian EGL në vitin 2025, Europe Goes Local, si një platformë për aktorët e punës rinore në nivel bashkiak, synon të mbështesë bashkitë në zhvillimin e një politike gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në njohuri për punën rinore, si dhe të ofrojë një kanal përmes të cilit bashkitë mund të bëjnë të dëgjohet zëri i tyre në diskutimet e politikave evropiane, duke kontribuar me një qëndrim të përbashkët për Konventën e ardhshme.

Synimet për vitin 2025:

- Të lehtësojë ndërtimin e njohurive dhe shkëmbimin e përvojave mbi zhvillimin e politikave lokale për punën rinore, me fokus të veçantë në mënyrën se si programet evropiane për të rinjtë mund të kontribuojnë në përmirësimin dhe fuqizimin e tyre.
- Të vërë në pah praktikat e suksesshme afatgjata dhe proceset e projekteve që kanë ndikuar ndjeshëm në zhvillimin e politikave lokale për punën rinore.
- Të nxisë diskutime dhe shkëmbime të thelluara mbi praktikat frymëzuese, duke theksuar zbatueshmërinë e tyre sistemike dhe praktike në kontekste të ndryshme lokale.
- Të krijojë një platformë përmes së cilës bashkitë mund të përcjellin mesazhe dhe rekomandime në Konventën e Katërt Evropiane për Punën Rinore.

- Të shqyrtojë sfidat dhe nevojat e bashkive në qasjen dhe përdorimin e programeve evropiane për të rinjtë, si dhe të identifikojë zgjidhje të mundshme.

6. A ka bashkia Politika Rinore të zhvilluar specifikisht për grupmoshën 15-29 vjec. Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet pse nuk eshte zhvilluar një politikë e tillë

Bashkia ka të hartuar një draft Plan Lokal të veprimit 2023-2025 i cili është përpjekur të adresojë në mënyrë të përgjithshme disa nga nevojat dhe çështjet dhe nevojat e grupmoshës 15–29 vjeç. Ky dokument përbën një hap të rëndësishëm drejt formalizimit të politikës rinore në nivel vendor, por ende nuk është finalizuar dhe miratuar si politikë/strategji e plotë rinore.

Në këtë kuadër, mund të theksohet se mungesa e një politike të miratuar deri më tani lidhet me disa faktorë, ndër të cilët:

- Procesi ende në fazë draftimi dhe konsultimi, që kërkon përfshirje më të gjerë të aktorëve rinorë dhe institucionalë;
- Nevoja për përditësim dhe konsolidim të të dhënave mbi të rinjtë, për të siguruar një bazë më të fortë analitike;
- Përfshirja graduale e prioriteteve rinore në dokumentet e planifikimit strategjik vendor, që ka bërë që procesi të zhvillohet në faza;
- Nevoja për forcim të kapaciteteve teknike për finalizimin dhe zbatimin e politikës rinore.

7. A keni në instiicionin tuaj një structure, njësi, drejtori të dedikuar për cështjët ë rinisë.

Po, në Bashkinë Durrës është ngritur Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, e cila përfshin edhe sektorin e sportit dhe rinisë. Ky sektor përfshin pozicionin e Inspektorit të Sportit dhe Rinisë.

8. A ka struktura rinore të ngritura në bashki.

Në bashkinë Durrës, është ngritur Këshilli Rinor Vendor, dhe gjithashtu një Qendër Rinore.

9. Me kë këni bashkëpunuar për ngritjen e strukturave të tilla.

Për ngritjen e Këshillit Rinor Vendor, Bashkia Durrës ka bashkëpunuar më Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile, Durrës, ndërsa për ngritjen e Qendrës rinore më organiztën World Vision Albania.

10 A keni një plan vendor për rininë, nëse po, specifikoni titullin, datën e miratimit dhe periudhën e zbatimit. Ju lutem bashkangjitni dukumentin.

Bashkia ka të hartuar një draft Plan Lokal Rinor, por ai ende nuk është finalizuar dhe miratuar si një politikë/strategji e plotë rinore. Ky plan parashikohet të rishikohet dhe të përditësohet gjatë vitit 2026.



11. Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e KVR

- Viti i krijimit: Tetor 2023
- Numri i anëtarëve: 13, 4 meshkuj, 9 vajza
- Persona me AK: 0
- Numri i mbledhjeve: 2
- Numri i aktiviteteve:5

12. Për cfarë lloj mbështetje keni nevojë për të përmirësuar funksionet e KVR?

Për të përmirësuar funksionimin dhe efektivitetin e Këshillit Vendor Rinor (KVR), nevojitet mbështetje në disa drejtime kryesore:

- Forcimi i kapaciteteve të anëtarëve të KVR-së përmes trajnimeve mbi pjesëmarrjen rinore, advokimin, hartimin e politikave publike dhe monitorimin e tyre;
- Rritja e burimeve financiare dhe logjistike, për të mundësuar organizimin e aktiviteteve, konsultimeve dhe nismave të drejtuara nga të rinjtë;
- Mbështetje për angazhimin dhe përfaqësimin më të gjerë të të rinjve, veçanërisht të grupeve vulnerabël dhe të rinjve nga zonat rurale;
- Shkëmbim përvojash dhe praktikash të mira me Këshilla Vendorë Rinorë dhe struktura të ngjashme në bashki të tjera.

13. A keni patur forma të tjera bashkëpunimi për zhvillimin e aktiviteteve me fokus të rinjtë?

Kemi patur bashkëpunime me organizata të tjera lokale lidhur me organizimin e aktiviteteve edukative, kulturore, sportive dhe sociale, programe të zhvillimit të aftësive, orientimit në karrierë, vullnetarizmit, pjesëmarrjes qytetare dhe fuqizimit të të rinjve.

14. Sa organizata rinore, qendra rinore oparojnë në bashkinë Durrës.

Në bashkinë Durrës operojnë aktivisht katër qendra rinore, të manaxhauara respektivisht nga: World Vision Albania, Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile, Udhëtimi i Lirë si edhe Durrës Aktiv

15. A ofrom Bashkia mbështetje për organizatat rinore.

Po, Bashkia Durrës ofron mbështetje konkrete për organizatat lokale që punojnë me të rinjtë. Për shembull, Bashkia ka vënë në dispozicion ambientet e rikonstruktuara të Qendrës Rinore, e cila menaxhohet nga Ëorld Vision Albania, me qëllim ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve për të rinjtë. Gjithashtu, Bashkia vë në dispozicion sheshe publike, ambiente kulturore dhe

hapësira të tjera komunitare për organizimin e aktiviteteve kulturore, artistike, edukative dhe rinore.

16. Jepni informacion mbi aktivitetet për të rinjtë të organizuara ose mbështetura nga Bashkia Durrës gjatë 2025.

Gjatë vitit 2025, Qendra Kulturore "Aleksandër Moisiu" ka zhvilluar një sërë aktivitetesh artistike, edukative dhe kulturore me fokus përfshirjen dhe promovimin e talenteve të reja të qytetit të Durrësit. Këto aktivitete kanë krijuar hapësira për shprehjen artistike, zhvillimin e aftësive krijuese dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën kulturore të qytetit.

Aktivitetet kryesore të realizuara:

- Koncerti "Këngët e Rinisë"
- Koncert Gala i Orkestrës së Harqeve
- Koncerte të Orkestrës Frymore
- Koncerti "Dua më shumë Shqipërinë"
- Koncerti "Pranvera filloi me ardh'"
- Ekspozita "Ekuinoksi Pranveror"
- Ekspozita artistike "Kur Ngjyrat Flasin"
- Ekspozita "Magjia e Dhjetorit"
- Konkursi "Ilustrimi më i bukur i kopertinës"
- Ekspozita artistike e nxënësve të shkollave të qytetit

Përmes këtyre aktiviteteve janë angazhuar qindra të rinj të grupmoshave të ndryshme në fushat e muzikës, pikturës, ilustrimit, këngës, instrumentit dhe arteve pamore. Aktivitetet kanë shërbyer si platformë për zbulimin dhe promovimin e talenteve të reja, duke forcuar lidhjen e të rinjve me institucionet kulturore dhe duke kontribuar në pasurimin e jetës artistike të qytetit.

Qendra Kulturore "Aleksandër Moisiu" ka vijuar të mbetet një pikë referimi për edukimin kulturor dhe artistik të të rinjve, duke nxitur kreativitetin, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen aktive në zhvillimin kulturor të Durrësit.

Gjithashtu, Bashkia Durrës, në kuadër të thirrjes për projekte kulturore dhe sportive gjatë vitit 2025, ka mbështetur projektet e mëposhtme:

- Kampionati Botëror i Shahut për të Rinjtë;
- Turneu i Boksit "Dorezat e Arta";
- Teuta Maratonë.

Po ashtu, në bashkëpunim me Klubin Shumësportësh Teuta, janë organizuar kampionate lokale për të rinjtë në sporte të ndryshme, si basketbolli, volejbolli, atletika (gara vrapimi) dhe noti.

Këto aktivitete kanë kontribuar në promovimin e sportit, jetesës së shëndetshme dhe angazhimit aktiv të të rinjve në jetën komunitare.

17. Në cfarë mënyrash përfshihen të rinjtë në proceset vendimarrëse të bashkisë?

Të rinjtë përfshihen në proceset vendimmarrëse të Bashkisë përmes disa mekanizmave dhe formave të ndryshme të pjesëmarrjes qytetare, si më poshtë:

- Përmes Këshillit Vendor Rinor, i cili shërben si strukturë këshilluese dhe përfaqësuese e të rinjve në nivel vendor dhe kontribuon me opinione dhe rekomandime në politikat rinore;
- Përmes konsultimeve publike dhe takimeve të hapura, ku të rinjtë ftohen të japin mendime dhe sugjerime mbi dokumente strategjike, plane dhe projekte që ndikojnë në komunitet;
- Përmes pjesëmarrjes në aktivitete dhe forume rinore, të organizuara nga Bashkia ose në bashkëpunim me organizatat partnere;
- Përmes bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe qendrat rinore, të cilat luajnë rol ndërmjetësues në artikulimin e zërit të të rinjve;

18. Gjatë vitit të fundit sa konsultimë publike me pjesëmarrjen e të rinjve ka organizuar bashkia?

Konsultimet publike të realizuara nga Bashkia janë të hapura dhe kanë pjesëmarrjen e të gjitha grupmoshave të interesuara.

19. Cilat janë sfidat kryesore që has bashkia në angazhimin e të rinjve në proceset e vendimarrjes locale?

Bashkia përballet me disa sfida kryesore në angazhimin efektiv të të rinjve në proceset e vendimmarrjes lokale, ndër më kryesoret janë sin ë vijim:

- Pjesëmarrje e kufizuar dhe e paqëndrueshme e të rinjve në konsultime publike dhe procese vendimmarrëse, shpesh e ndikuar nga mungesa e interesit ose informacionit;
- Kapacitete të kufizuara organizative dhe logjistike për të garantuar përfshirje më të gjerë dhe më gjithëpërfshirëse të të rinjve në të gjitha fazat e vendimmarrjes;
- Lëvizshmëria dhe migrimi i të rinjve, që ndikon në vazhdimësinë e angazhimit të tyre në nivel lokal;

20. A përdor bashkia platforma ose mjete digitale për të lehtësuar pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimarrëse?

Nuk ka ndonjë platformë digitale

21. A ofrom bashkia mbështetje për sipërmarrjen rinore.

Po, gjatë vitit 2025 bashkia Durrës hapi thirrjen “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale “ me buxhet 4,000,000 lekë

22. Ju lutem ndani praktika të mira, histori suksesi ose inisiativa të suksesshme që lidhen me pjesëmarrjen e të rinjve.

Bashkia ka zhvilluar disa praktika të mira dhe iniciativa të suksesshme që lidhen me pjesëmarrjen aktive të të rinjve në jetën komunitare dhe vendimmarrjen lokale, ndër të cilat mund të përmenden:

- Funksionimi i Këshillit Vendor Rinor (KVR) si një mekanizëm konsultativ, i cili ka mundësuar përfshirjen e të rinjve në diskutimin e prioriteteve dhe politikave rinore në nivel bashkie;
- Ngritja e Qendrës Rinore, si hapësirë e dedikuar për të rinjtë, ku ata angazhohen në aktivitete edukative, sociale dhe kreative, si dhe në nisma vullnetare dhe komunitare;
- Zbatimi i projekteve kulturore dhe sportive me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të të rinjve, të cilat kanë nxitur angazhimin e tyre në organizim dhe pjesëmarrje aktive;
- Bashkëpunimi me organizata partnere, si Ëorld Vision Albania, për fuqizimin e të rinjve përmes programeve të zhvillimit të aftësive, vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes qytetare;
- Përfshirja e të rinjve në aktivitete sportive dhe kulturore në nivel qyteti, përmes partneritetit me institucione dhe klube sportive, duke krijuar mundësi për talentet e reja dhe angazhim komunitar.

23.A ka masa ose programe specifike per grupet vulnerabel te te rinjve, si: (te rinjte me aftesi te kufizuara; te rinjte NEET (jo ne arsim, punesim ose trajnim); te rinjte rome dhe egjiptiane; te rinjte ne zonal rurale; vaj::at dhe grate e reja; grupe te tjera vulnerabel).

Po, ekzistojnë masa dhe shërbime për grupet vulnerabël të të rinjve, të ofruara përmes qendrave sociale dhe mekanizmave të mbrojtjes sociale, por ato janë kryesisht të integruara në sistemin ekzistues të shërbimeve sociale dhe jo të ndara si programe specifike vetëm për të rinjtë.

Këto përfshijnë:

* Të rinjtë me aftësi të kufizuara (PAK):

Përfitojnë pagesa paaftësie dhe shërbime në qendra komunitare, si dhe mbështetje përkujdesjeje.

* Të rinjtë NEET:

Nuk identifikohen drejtpërdrejt si kategori më vete në të dhëna, por mbështeten përmes ndërmjetësimit për punësim dhe shërbimeve sociale.

* Të rinjtë romë dhe egjiptianë:

Janë përfitues të shërbimeve në qendrat komunitare, me mbështetje sociale dhe integruese për familjet dhe fëmijët.

* Të rinjtë në zona rurale:

Përfitojnë përmes shërbimeve të integruara komunitare dhe qendrave sociale ekzistuese.

* Vajza dhe gra të reja në nevojë:

Përfshihen në shërbime për rastet e dhunës në familje, mbështetje sociale dhe akomodim emergjent, si dhe trajtim për viktima të dhunës dhe trafikimit.

* Grupet e tjera vulnerabël:

Përfshihen të rinj përdorues të drogës, të rinj në shërbim prove, si dhe fëmijë dhe të rinj në risk, në varfëri apo jashtë sistemit arsimor.

24. Sa është numri total i përfituesve nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?

Totali: 326 përfitues

Femra:

Meshkuj:

25. Sa është numri e të rinjve (15-29 vjeç) përfitues nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?

Numri total i te gjithe grupmoshave: 333 përfitues

Femra:

Meshkuj:

26. Sa është numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?

Totali: 3506 përfitues

Femra:

Meshkuj:

27. Sa është numri e të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?

Totali:

Femra:

Meshkuj:

29. Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2025? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?

Totali: 20 (15-21 vjec)

Femra: 3

Meshkuj: 17